



100 Vjet Pavarësi

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Ministri**

Nr. ... Prot.

Tiranë, më 18.10.2012.

**URDHËR**

Nr. 487, datë 18.10.2012.

**PËR**

**HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL NË "INXHINIERI INDUSTRIALE", "INXHINIERI SOFTUERIKE", "ADMINISTRIM BIZNESI" DHE MASTER I SHKENCAVE NË "INXHINIERI INDUSTRIALE", "INXHINIERI SOFTUERIKE", "ADMINISTRIM BIZNESI" PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË".**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Nenit 44/1 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 781, datë 10.11.2011 "Për liçensimin e shkollës së lartë universitare private, " Instituti Kanadez i Teknologjisë".

**URDHËROJ:**

1. Hapjen në përputhje me vendimin nr. 366, datë 17.09.2012 të Këshillit të Akreditimit (bashkëlidhur këtij urdhëri), pranë Shkollës së Lartë Universitare Private "Instituti Kanadez i Teknologjisë", të programeve të studimit të ciklit të dytë:
  - a) Master Profesional në "Inxhinieri Industriale", "Inxhinieri Softuerike", "Administrim Biznesi";
  - b) Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale", "Inxhinieri Softuerike", "Administrim Biznesi".



2. Programet e studimit Master Profesional në "Inxhinieri Industriale", "Inxhinieri Softuerike", "Administrim Biznesi" realizohen me 90 kredite, me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë universitare Master Profesional në "Inxhinieri Industriale", "Inxhinieri Softuerike", "Administrim Biznesi".  
Programet e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale", "Inxhinieri Softuerike", "Administrim Biznesi" realizohen me 120 kredite, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë universitare Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale", "Inxhinieri Softuerike", "Administrim Biznesi".
3. Programet e studimit të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi, të plotësojnë sugjerimet e Këshillit të Akreditimit dhënë në vendimin nr. 366, datë 17.09.2012 (bashkëlidhur këtij urdhëri), brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhëri.
4. Programet e studimit të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri, të fillojnë veprimtarinë akademike në vitin akademik 2012-2013.
5. Shkolla e Lartë Universitare Private "Instituti Kanadez i Teknologjisë" duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve studimi, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhëri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhëri Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe Shkolla e Lartë Universitare Private "Instituti Kanadez i Teknologjisë".

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.*

MYQEREM TAFAJ

  
MINISTËR

